

ADMINISTRATA E PËRKOHËSHME E OKB-së NË KOSOVË-UNMIK

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës

01 Nr.6/2001 më 24.01.2001

M i t r o v i c ë

Në zbatim të nenit 3 të Rregullorës për vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP, Kuvendit të Komunës së Mitrovicës i propozohet për aprovim, ky projekt-vendim:

VENDIM

**PËR MBIKQYRJËN DHE ADMINISTRIMIN E PËRKOHËSHËM
NGA ANA E KUVENDIT TË KOMUNËS PËR OBJEKTET
AFARISTE, SELIA E TË CILAVE GJENDET JASHTË KOSOVËS**

Në administrim dhe mbikqyrje të përkohëshme të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, mbi bazën e këtij Vendimi do të hynë:

1. Lokali afarist "Beko"
2. Lokali afarist "Borovo"
3. Lokali afarist "Novi Pazar"
4. Lokali afarist "Sport"
5. Lokali afarist "Novi Dom"
6. Lokali afarist "Oriolik"
7. Lokali afarist "Sllavonija"
8. Lokali afarist "Obuqa"
9. Lokali afarist "BIP"
10. Lokali afarist ""
11. Lokali afarist "Krash"
12. Lokali afarist "Varteks"
13. Lokali afarist "Peko" "Planika"
14. Pikat e distribuimit "INA" dhe "Beopetrol"
15. Lokali afarist depo "Gornji Ibar"
16. Lokali afarist depo "Drvoimpex"
17. Lokali afarist depo "Bor Plav"
18. Lokali afarist depo "Jugoshped"
19. Lokali afarist "Treska"
20. Lokali afarist "Brodoimpex"
21. Lokali afarist "Iskra"

- 22.Lokali afarist depo“Srbolek”
23.Lokali afarist “Investbanka”

- II. Kushtet e mbikqyrjës dhe administrimit të përkohëshëm do
ti caktojë Komiteti për politikë dhe Financa me akt të
posaqëm.

Mitrovicë.

E mërkurë, 2001-01-24



KRYETARI I KOMUNËS
Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS nr.22/01

42/01
22.02.01

Në mbledhjen e mbajtur më 22.02.2001, duke shqyrtuar kërkesën e "World Helth Organization"- Kosovë dhe propozimin e Drejtorisë për Urbanizëm, Kuvendi i Komunës, nxorri:

**VENDIM
PËR DHËNJËN E TOKËS NDËRTIMORE "QENDRËS
RAJONALE PËR SHËNDET MENTAL"-MITROVICË**

- I. I ipët në shfrytëzim toka për ndërtimin e Qendrës regjionale për shëndet mental të Mitrovicës, në lokacionin "Ilirida" dhe parcelat sipas sygjërimit të Drejtorisë kompetente të datës 21.02.2001
- II. Detajet e përcaktimit të lokacionit dhe të sipërfaqes do të përcaktohen nga ana e Drejtorisë për Urbanizëm të Kuvendit të komunës së Mitrovicës.
- III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, kurse aplikohet pasi të ketë caktuar kushtet Drejtoria përkatëse, konform Ligjit për tokë ndërtimore.

Mitrovicë,
22.02./2001



KRYETARLI KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS, 01 Nr.16/01

25/01

Mitrovicë, e enjte, 2001-03-15

Në zbatim të dispozitave të Nenit 30 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe të nenve 88, 89 dhe 90 të udhëzimit administrativ të dhënë nga ana e PSSP, Kuvendi i komunës së Mitrovicës në seancën e vet të mbajtur më _____ 2001 nxorri:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOLEXHIT PËR ZGJEDHJËN E KRYESHEFIT
EKZEKUTIV DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE

- I. Formohet Kolexhi për zgjedhjen e Kryeshefit ekzekutiv dhe të Drejtorëve të Drejtorive, në përbërje sa vijon:
 1. Faruk SPAHIJA, kryetar
 2. Bajram KAJTAZI, anëtar
 3. Bejtullah BEJTULLAHU, anëtar
 4. Rasim VESELI, anëtar
 5. Sadija NIKSHIQ, anëtar
- II. Detyrë e kolexhit është që të zbatojnë procedurën zgjedhore sipas akeve normative për Kryeshefin ekzekutiv dhe për Drejtorët e drejtorive.
- III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS, 01 Nr. ~~28/01~~ 32/01

Mitrovicë, e mërkurë, 2001-03-28

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në mbledhjen e vet të rregulltë më 23.03.2001, pasi ndëgjoi raportin e përfaqësuesit të Policisë së UNMIK-ut- stacioni jugor, në mbështetje të dispozitave të Rregullorës për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nxorri:

V E N D I M **MBI NDALIMIN E QARKULLIMIT TË** **LODRAVE ARMË PËR FËMIJË**

- I. Ndalohet shitblerja e lodrave të fëmijëve me formë të armëve në teritorin e komunës së Mitrovicës.
- II. Obligohen organet përkatëse që bëjnë mbikqyrjen e aplikimit të ligjshmërisë nga lëmi i tregut dhe qmimeve që të zbatojnë këtë vendim.
- III. Për subjektët që nuk e respektojnë këtë vendim do të ndërmerren masa ndëshkimi me konfiskim malli dhe me gjobë në të holla, lartësia e të cilit do të caktohet me vendim të posaçëm.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, kurse aplikohet nga dita e 3 (Tretë) e publikimit në mediat lokale.



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk Spahija
Faruk SPAHIJA


KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS, 01 Nr.40/01

Mitrovicë, e martë, 2001-04-10

Në zbatim të dispozitave të Rregullorës për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, në seancën e vet të datës 7.04.2001, nxorri:

VENDIM PËR EMRIMIN E DREJTORËVE TË DREJTORIVE

- I. Emrohet z. Mursel Ahmeti, jurist i diplomuar nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për administratë të përgjithëshme
- II. Emrohet z. Besim Kurti, ekonomist i diplomuar nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për Inspektion.
- III. Emrohet z. Bedri Hamza, Ekonomist i diplomuar nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për ndërmarrje publike.
- IV. Emrohet z. Murteza Berisha, profesor i letërsisë shqipe, nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për arsim, kulturë, sport e rini.
- V. Emrohet z. Gani Beshiri, inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për urbanizëm, rindërtim dhe zhvillim
- VI. Emrohet z. Vahid Avdiu, inxhinjer i diplomuar i bujqësisë, nga Mitrovica, për Drejtor të drejtorisë për Bujqësi.
- VII. Emrohet z. Tefik Ujkani, magjistër i shkencave ekonomike nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për ekonomi e Financa.
- VIII. Emrohet znj. Sadije Asllani-Bilalli, specialiste e medicinës së punës, nga Mitrovica, për drejtor të drejtorisë për politikë sociale dhe shëndetësore.
- IX. Emrohet z. Fadil Selmanaj, inxhinjer i diplomuar i gjeodezisë, nga Mitrovica, për Drejtor të Drejtorisë për Gjeodezi, kataster dhe shërbime pronore-juridike.
- X. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, kurse aplikohet pasi të nënshkruhet kontrata nga ana administratës së UNMIK-ut dhe Drejtorëve të Drejtorive.



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS, 01 Nr.69/01

Mitrovicë, e martë, 2001-06-05

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, në zbatim të nenit 3 al. 1 pika (II) e Rreg. 2000/45, pasi mori në shqyrtim mendimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe propozimin e Drejtorisë për Urbanizëm, Zhvillim dhe Rindërtim, në seancën e vet të 8-të të mbajtur më 04.06.2001 me shumicë votash nxorri:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT TË VARREZAVE TË
QYTETIT**

- I. Toka shoqërore e cila deri tash i është dhënë në shfrytëzim Kooperativës Bujqësore, që gjendet në anën e djathtë të rrugës Mitrovicë –Skenderaj, në mes të fshatrave Shiopol, Zhabarë i Epërmë dhe Lushtë, caktohet për lokacion të varrezave të qytetit.
- II. Drejtoria për Urbanizëm, obligohet që ta përpiloj planin detal urbanistik të varrezave.
- III. Kuvendi i Komunës, pas pranimi të planit detal urbanistik të varrezave dhe të caktoj rregullat dhe përgjegjësitë e administrimit të varrezave.
- IV. Me këtë vendim të njoftohen drejtoritë për urbanizëm, shërbime publike dhe gjeodezi e kataster.
- V. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, kurse aplikohet pas marrjes së konstatimit laboratorik për mundësin e ndikimit të varrezave në ujsjellës.

Mitrovicë,
e martë, 2001-06-05



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

8/01

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS, 01 Nr.38/01

Mitrovicë, e mërkurë, 2001-04-04

Në zbatim të dispozitave të Rregullorës për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP, Kryetari i Kuvendit , nxorri:

**VENDIM
PËR PÛRKRAHJËN E PROJEKTIT TË KANALIZIMIT NË
LAGJEN SHIPOL**

- I. Përkrahët projekti në realizim i kanalizimit në lagjën Shipol në shumë prej 10.000 DM (Dhjetëmijëmarkagjermane)
- II. Shuma e përmendur ndahet nga buxheti kapital, në formë të huasë.
- III. Ky aktvendim hynë në fuqi menjëherë



KRYETARI I KUVENDIT


Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS MITROVICË

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, në zbatim të dispozitave të nenit 22 dhe të nenit 23, pika 1, 2 dhe 3 të Rreg. mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës 45/2000 në seancën e vet të 8-të, nxorri:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

Formohet komiteti i Komuniteteve, në përbërje :

1. Osman Haziri, LDK
2. Shahin Fetahu, PDK
3. Sadia Nikshiq, komuniteti boshnjak
4. Ergyn Koroglu, komuniteti turk
5. Bajram Avdiu, komuniteti ashkali

**Mitrovicë,
05.06.2001**



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS MITROVICË

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, në zbatim të dispozitave të nenit 22 dhe të nenit 23, pika 1, 2 dhe 3 të Rreg. mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës 45/2000 në seancën e vet të 8-të, nxorri:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR NDËRMJETËSIM

Formohet Komiteti i Ndërmjetsimit, në përbërje:

1. Mensur Kelmendi, LDK
2. Mehmet Bajrami, PDK
3. Nazmi Fejza, AAK
4. Izetdin Feratoviq, komuniteti boshnjak
5. Shenaj Bashota, komuniteti turk
6. Agim Fetahu, komuniteti ashkali

**Mitrovicë
05.06.2001**



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS
Nr.p 103/01
MITROVICË

Në bazë të konkluzioneve të Komitetit për politik dhe financa të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, të datës 23.07.2001 dhe propozimit të KNI "Ramiz Sadiku", Kuvendi i Komunës në Mitrovicë, sjellë:

V E N D I M

Për Kompenzimin e KNI "Ramiz Sadiku" në emër të vazhdimit të punëve në objektin Banesoro-Afarist "03" në lokalitetin "Kej Lushta".

1. Obligimi financiar i KNI "Ramiz Sadiku" ndaj Kuvendit Komunal në Mitrovicë, lidhur me kompenzimin për rregullimin e tokës ndërtimore dhe kompenzimit për mardhënjet pronaro –juridike kapë vlerën 694.030 DM.

2. KNI "Ramiz Sadiku", Kuvendit Komunal në Mitrovicë këtë obligim do t'ia kompenzoj me:

- 9. banesa tri dhomshe, me sipërfaqe të një banese 74.17 m²
- 1. banesë dy dhomshe me sipërfaqe prej 51.61 m²

Arsyetimin për këtë propozim vendim do ta jap Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, ndërtim, rindërtim dhe planifikim në seancë. (nese këtë nuk e dorzon me shkrim).

Këto banesa do të jenë në vertikale të objektit banesor.

Për këtë Vendim lidhet kontrata dy palshe, në mes të Kuvendit Komunal dhe KNI "Ramiz Sadiku".

Ky vendim hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit të kontratës.



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

Në mbështetje të dispozitave Rregullorës për Vetqeverisjen e komunave të Kosovës 45/2000 dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP pas aprovimit nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në seancën e vet të 9-të, të mbajtur më 28.07.2001 nxorri:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E QIRASË PËR LOKALET NË PRONËSI TË KOMUNËS

- I. Caktohet qiraja mujore për lokalet në pronë të komunës duke filluar nga 01.07.2001 sipas propozimi të drejtorisë për Urbanizëm
- II. Qiraja fillestare caktohet deri më 31.12.2001 me mundësi vazhdimi
- III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas deklarimit të Kuvendit në favar
- IV. Bordi i drejtorëve dhe drejtoritë përkatëse obligohën që ta zbatojnë vendimin.

Shtojcë: propozimi (pa parti politike)

Mitrovicë

Më 24.07.2001



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA d.v

Në mbështetje të nenit 39 dhe 41 të Rregullorës për Vetqeverisjen e komunave të Kosovës 45/2000 dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP mbi aprovimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, pas aprovimit nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në seancën e vet të 9-të, të mbajtur më 28.07.2001, nxorri:

VENDIM

MBI APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2001

- I. Buxheti komunal është i bazuar në realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2000, buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2001 nga AQF dhe të aprovuar nga KPA i Kosovës si dhe parashikimi i aktivitetit komunal duke përfshirë A i Kosovës si dhe parashikimi i aktivitetit komunal duke përfshirë të hyrat shpenzimet dhe investimet kapitale.
- II. Të hyrat: 2.230.154 DM
- - Granti nga Pushteti Qëndror 1.519.000 DM
 - - Pjesa e obliguar e komunës 303.000 DM
 - - Bartje nga viti i kaluar 408.154 DM
- Shpërndarja : 2.230.154
- pagat dhe pagesat 807.360 DM
 - mallrat dhe shërbimet 624.640 DM
 - zyra e komuniteteve 390.000 DM
 - shpenzime kapitale, nevoja komunale dhe shërbime publike 408.154 DM
- III. Ky vendim ka hyrë në fuqi më ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit, dhe pasi ka marrë aprovimin e Administratorit komunal, kurse aplikohet nga 01.01.2001./

Mitrovicë,
28.07.2001



KRYETARI I KUVENDIT
Faruk SPAHIJA d.v

Në mbështetje të dispozitave Rregullorës për Vetqeverisjen e komunave të Kosovës 45/2000 dhe të Udhëzimeve administrative të PSSP pas aprovimit nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës në seancën e vet të 9-të, të mbajtur më 28.07.2001, bjen:


VENDIM
PËR CAKTIMIN E VULËS SË PËRKOHËSHME TË KUVENDIT
TË KOMUNËS SË MITROVICËS

- I. Vula e përkohëshme e Kuvendit të Komunës do të jetë në formë të rrumbullakët dhe katërkëndëshe, me dimensione standarde,.
- II. Teksti i Vulës do të jetë në gjuhën shqipe “Kuvendi i Komunës” dhe serbe me alfabetin latin “Skupstina Opstine” Mitrovicë-Mitrovica
- III. Kushtet e përdorimit do të caktohen me rregullore të posaçme që do të përgatitet nga Bordi i Drejtorëve.
- IV. Ky vendim ka karakter të përkohëshëm dhe zgjatë deri në nxjerrjen e Statutit të komunës.

Mitrovicë,
28.07.2001



KRYETARI I KUVENDIT


Faruk SPAHIJA d.v

KUVENDI I KOMUNËS MITROVICË

Kuvendi i Komunës në bazë të Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës neni 3 al 1 pika 10 dhe 12 dhe në bazë të instruksionit administrativ 2/1999 për testimin dhe zbatimin e standarde minimale mbi kualitetin e ujit të pijëshëm dhe të vendimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës sjell këtë:

VENDIM PËR PËRCJELLJEN E KUALITETIT TË UJIT TË PIJËSHËM

I

Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që nga ana e Institutit Regjional për Shëndetësi Publike në Mitrovicë të përcillet kualiteti i ujit të pijëshëm në 10 fshatra të Komunës së Mitrovicës të zgjedhura me prioritet në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Inspeksionin Sanitar.

II

10 fshatra të zgjedhura me prioritet janë: Kqiç, Koshtovë, Vidishiq, Bare, Rahovë, Rashan, Qabër, Bajgorë, Broboniq dhe Vërnice.

III

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të lidhë kontratë me Institutin Regjional për Shëndetësi Publike për kontrollimin e ujit të pijëshëm.

IV

Çmimi për një analizë kimike të ujit është 50 DM ndërsa për një analizë bakteriologjike është 30 DM, gjithsejt 80 DM. Analiza bëhet 4 herë në vit nga dy pika të marrjes, apo për një fshat shuma e përgjithshme 640 DM x 10 fshatra, gjithsejt 6400 DM për një vit (për këtë vit kontraktimi i përcjelljes së kualitetit të ujit bëhet për periudhën korrik-dhjetor shuma e përgjithshme 3200 DM).

V

Instituti Regjional për Shëndetësi Publike në Mitrovicë t'i raportoi për gjendjen e konstatuar të kualitetit të ujit të pijëshëm Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Mitrovicë

Mitrovicë
04.09.2001



Kryetari i Kuvendit

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS MITROVICË

Në bazë të Rregullores për Vetqeverisjen e komunave të Kosovës 200-/45 neni 91 dhe mbështetur në vendimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 04.09.2001 Kuvendi i Komunës së Mitrovicës sjellë:

V E N D I M

I

Për hapjen e 33 vendeve të punës në postet komunale në Mitrovicë

II

Për hapjen e 7 vendeve të punës në Biblotekën e qytetit në Mitrovicë

III

Për hapjen e 4 vendeve të punës në Muzeun e qytetit në Mitrovicë

IV

Për hapjen e 6 vendeve të punës në Qendrën e Sportit në Mitrovicë

V

Për hapjen e 9 vendeve të punës në Qendrën e Kulturës në Mitrovicë

VI

Konkursi të shpallet në:

1. Tabelën e shpalljeve të Komunës
2. Qendrën regjionale për punë dhe punësim
3. Mjetet e Informimit Publik

VII.

Afati i konkurimit, procedura e aplikacionit dhe kushtet e konkursit sipas vendimit fuqplotë të Kuvendit Komunal



KRYETARI I KUVENDIT
[Signature]
Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS SË

Datë 05.09.2001

MITROVICË

Në bazë të statutit të Ndërmarrjes komunale publike “Ujësjiellësi Regjional” dhe aprovimit në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës sjell këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN DHE EMËRIMIN E BORDIT ADMINISTRATIV TË NKP-SË “UJËSJELLËSI REGJIONAL”

I.

Sipas nenit 14 të statutit të NPK-së “Ujësjiellësi Regjional” Bordi Administrativ emërohet nga Kuvendi Komunal. Bordi Administrativ numëron 7 anëtarë, prej të cilëve nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal mund të jenë më së tepërmi 3 anëtarë. Ata duhet të kenë njohuri nga biznesi, administrata, shërbime publike ose si përfaqësues të bashkësive të gjëra.

II.

Përfaqësimi i anëtarëve të Kuvendit Komunal, nga 3 anëtarë sa ka gjithsejt, 2 do të jenë nga radhët e LDK-së dhe 1 nga PDK-ja, ndërsa Drejtori i drejtorisë për shërbime publike do të jetë gjithashtu anëtar i Bordit Administrativ.

Mitrovicë

05.09.2001



Kryetari i Kuvendit

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS
Nr. pr. 137/01dt.13.09.2001
MITROVICË

Në bazë të rregullores për vetqeverisjen e komunave të Kosovës 2000/45 neni 5, al,5.1 dhe mbështetur në vendimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 04.09.2001, Kuvendi i Komunës merr këtë :

V E N D I M

I

Që në Kodrën e minatorëve në Mitrovicë të ndërtohet objekti për ambulantë shëndetsore Tri dhomëshe me madhësi prej 76.00 m².

II

Objekti ndërtohet në Parcelën katastrale nr.2496/1, me emër të regjistrit 3301.

Në këtë objekt shëndetsor do të bëhet përkujdesja shëndetsore për Popullatën e këtij lokaliteti, dhe sadopak do ta zbusë gjendjen e rëndë të banorëve të Kodrës së Minatorëve.

Me këtë vendim të njoftohen drejtoritë për urbanizëm, për shëndetësi, shërbime publike, gjeodezi dhe kataster.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi

Mitrovicë
13.09.2001



KRYETARI I KUVENDIT

Faruk SPAHIJA

KUVENDI I KOMUNËS
MITROVICË Nr.147/01

Kuvendi Komunal në mbledhjen e vet të mbajtur më 07.12.2001
duke u bazuar në rregulloren 2000/45, neni 3, al 1, pika 2 mori këtë:

VENDIM

Që Kuvendi Komunal në meremetimin e rrugës Melenicë – Vllahi
të participoi në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) DM.

Mitrovicë
18.12.2001



Kryetari i Kuvendit

Faruk SPAHIJA